

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.08/2022	Data: 15.02.2022	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d), nenit 41, paragrafi 41.1 dhe 41.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008 e publikuar më 04.06.2008); nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 2009/01 për Procedurën e Zgjedhjes dhe Përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës; nenit 36, paragrafi 36.1 dhe 36.2 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Numër 62/10 të datës 30.11.2010; nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 dhe nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 15.02.2022 mori këtë:

V E N D I M

Për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Istogut

1. **MIRATOHET** Vendimi për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Istogut.
2. Kryesues i Kuvendit, sipas pikës 1 të këtij vendimi, zgjedhet **Enver Rugova** nga Cërrca, Komuna e Istogut.
3. Mandati i Kryesuesit të Kuvendit është i njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës.
4. Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës janë të parapara me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Istogut, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 2009/1 për Procedurën e Zgjedhjes dhe Përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe ligjet tjera në fuqi.
5. Kryesuesi i Kuvendit njëkohësisht kryeson edhe mbledhjet e Komunitetit për Politikë dhe Financa.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në uebfaqe të Komunës ashtu siç përcaktohet sipas dispozitave ligjore të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës.
7. Me Kopje të këtij vendimit të njoftohen: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, MAPL, Arkivi, Kryetari i Komunës dhe Zyra e Personelit.


 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
 Uales-Izlazna

00 Nr: 06-039 Data 15.02.2022
 Br: Datum

ISTOG-ISTOK


 Kryesuesi i Mbledhjes,
Zenel Shatri